

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË LABORATORI I
REFERENCËS
DHE LABORATORËT E AKREDITURA DHE ANALIZAT QË
KRYEJNË KËTA LABORATORË

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

1. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë kriteret që duhet të plotësojë laboratorit i referencës i akredituar dhe laboratorët e akredituar për tu miratuar dhe analizat që kryejnë këta laboratorë.

Ky projektvendim synon të arrijë këto objektiva:

- përcaktimi i kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësojë laboratorit i referencës i akredituar dhe laboratorët e akredituar për tu miratuar, në përshtatje me standardet ISO-9001;
- përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojë stafi i laboratorit, lidhur me eksperiencën dhe kualifikimin për zbatimin e procedurave dhe metodave të analizave laboratorike sipas rregullores së ISTA-as;
- kryerjen e analizave të mostrave të farave të bimëve bujqësore për efekt verifikimi të treguesve cilësor të deklaruar (për farat e bimëve bujqësore të importuara) si dhe verifikimi i treguesve cilësorë të farave të bimëve bujqësore që prodhohen në vend;
- kryerjen e analizave laboratorike sipas metodikave të testimit dhe rregullores së ISTA;
- përcaktimi i rregullave për plotësimin e fletë analizës me rezultatet përfundimtare për të gjitha llojet e analizave që kryen, si dhe procedurën e mëtejshme që ndiqet për analizat zyrtare;
- përmirësimin e cilësisë dhe besueshmërisë së analizave, rianalizimin e materialit mbjellës e shumëzues bimor për kontrollin e treguesve për fuqisë mbirëse.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,

ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Përgatitja e këtij projektvendimi është detyrim ligjor i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, bazuar në programin vjetor legjislativ, të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.136, datë 24.02.2016 “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2016”.

Projektvendimi është pjesë e paketës së akteve nënligjore që dalin në zbatim të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, përkatësisht të pikës 4 të nenit 44 të këtij ligji, të cilat synojnë të plotësojnë kuadrin ligjor për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në Republikën e Shqipërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi përcakton kriteret që duhet të plotësojë laboratorit i referencës i akredituar dhe laboratorët e akredituar për tu miratuar si dhe analizat që kryejnë këta laboratorë, dizenjimin e rrjetit të matjeve në shkallë kombëtare për testimin e varieteteve që duhet të regjistrohen në Katalogun Kombëtarë, si dhe rrugët që ndiqen për këtë qëllim.

Ky projektvendim përcakton rregullat dhe përgjegjësitë që ka laboratorit i referencës për plotësimin e standardeve ISO-9001, rregullat që duhet të zbatohen për të promovuar rezultatet e analizave, si dhe përgjegjësinë e këtyre laboratorëve për hartimin e programeve të veçanta për analizimin apo testimin e materialit mbjellës e shumëzues bimor.

Gjithashtu projektvendimi përcakton kohën e nevojshme të aktivitetit prej 10 vitesh të laboratorit në fushën e kryerjes së analizave dhe si monitorues të nivelit të lartë për përcaktimin e treguesve cilësor të materialit mbjellës e shumëzues bimor për të qenë laboratorë reference dhe laboratorë të akredituar. Projektvendimi përcakton rregullat e kontrollit të cilësisë së materialit mbjellës e shumëzues bimorë të importuar apo prodhuar brenda vendit, përmes krahasimit të rezultatit të analizave të mostrave me treguesit e deklaruar në etiketë ose në certifikatën e origjinës.

Projektvendimi ka 5 shtojca të cilat përcaktojnë në mënyrë të hollësishme modelin e regjistrimit, llojet e analizave që kryen laboratorit si dhe pajisjen me fletë analizën përkatëse të çdo mostre të materialit mbjellës e shumëzues bimorë që analizohet.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ligji nr. 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” është miratuar me Dekretin nr. 6982, datë 20.4.2011. Projektvendimi është përgatitur në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, në zbatim të kërkesës të pikës 4 të nenit 44, të ligji nr. 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” në përshtatje me rregulloret që aplikon ISTA, në përshtatje me rregullat e përcaktuara në standardin ISO-9001.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Nuk ka përafrim

VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është ndarë në 4 krerë.

Në kreun e parë, përcaktohet qëllimi i këtij projektvendimi dhe kuptimi i termave të përdorura, të cilat kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10416, datë 7. 04. 2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

Në kreun e dytë, përcaktohen kriteret që duhet të plotësojë laboratorit i referencës i akredituar dhe laboratorët e akredituar me qëllim miratimin nga ministri. Në këtë kre përshkruhen afati kohor i aktivitetit në fushën e kryerjes së analizave, funksionimi i laboratorit bazuar në rregulloren e miratuar nga ministri ose titullari sipas llojit të laboratorit, staf të mjaftueshëm me eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për zbatimin e procedurave dhe metodave të përshkruara në rregulloren e ISTA, si dhe nevojën për pajisje dhe ambiente sipas standardeve të ISO-9001.

Në kreun e tretë, përcaktohen analizat që kryen laboratorit i referencës i akredituar dhe laboratorit i akredituar si: analizat për certifikimin zyrtarë të materialit mbjellës e shumëzues bimor dhe testimin e varieteteve të reja për tu regjistruar në Katalogun Kombëtar (K.K), analiza zyrtare të materialit mbjellës që importohet, analiza për qëllime shkencore, analiza për efekt monitorimin e laboratorëve të tjerë.

Në kreun e katërt, përcaktohen dispozitat e fundit të këtij projektvendimi.

Me miratimin e këtij projektvendimi, do të bëhet i mundur, përcaktimi i kriterëve që duhet të plotësojë laborator i referencës i akredituar dhe laboratorët e akredituar për tu miratuar, analizat që kryejnë këto laboratorë në përshtatje me rregullat e ISTA dhe në plotësim të standardeve ISO-9001, duke bërë të mundur mbështetjen e prodhimit bujqësor me material mbjellës e shumëzues bimor të kontrolluar dhe me cilësi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga specialistët e Ministrisë Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (Drejtoria e Prodhimit Bujqësor dhe Blegtoral) dhe specialistët e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk ka efekte financiare.

MINISTRI

EDMOND PANARITI

Grupi i punës

Harun Zeqiri

Gëzim Xhixha

Vlash Tirana

Ilmi Meta